



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e Kryetarit

I nr.464-4400  
Data: 23.04.2013

Në mbështetje të neneve 13,14 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28 e dates 4 qershor 2008, neneve 17,40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 të dt.26.09.2008, dhe nenit 83 të Ligjit për procedurë administrative nr. 02 /L-28 duke vendosur në kërkesën e Drejtoratit të Prokurimit për bartje të së drejtës së shfrytëzimit, Kryetari i Komunës me dt.23.04.2013 merr:

#### AKTVENDIM

Për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit

- I. Aprovohet kërkesa e Drejtoratit të Prokurimit për bartje të së drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme në ngastrën kadastrale P-71409036-00164-4, P.Sh Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues për 99 vite Sh.P.K "Punëtori" Arian Idrizaj nga Prishtina.
- II. Obligohet DGJK-Sëktori për kadastrë dhe gjeodezi, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit në librat publike, P Sh Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues për 99 vite "Punëtori" Sh.p.k Arian Idrizaj nga Prishtina.

#### Arsyetim

Drejtorati i Prokurimit me kërkesë 1-464-4400 të dt.13.03.2013 ka kërkuar që të regjistrohet e drejta-bartja e shfrytëzimit në P Sh Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues për 99 vite Sh.P.K "Punëtori" Arian Idrizaj nga Prishtina. sipas marrëveshjes për dhënjën në shfrytëzim të paluajtshmerisë Nr.Ref.16303 009 058 611 shtator 2009. Kompanija Sh.P.K "Punëtori" është regjistruar në Qeverinë e Republikës së Kosovës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë Nr. I biznesit 70556197 me dt.19/09.2012 në emër të Arian Idrizaj nga Prishtina.

Në bazë të Certifikatës-Njësie kadastrale P-714036-00164-4 e evidentuar Nr.14-2498 ZK Konjuh lëshuar me dt. 28.03.2013, P.Sh Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues për 99 vite Sh.P.K "Punëtori" dhe i shtohet emri Arian Idrizaj nga Prishtina. Në bazë të marrëveshjes për dhënjën në shfrytëzim të paluajtshmerisë Nr.Ref.16303 009 058 611 shtator 2009 të ngastrës kadastrale P-71409036-00164-4 me sipërfaqe prej 1.90,95 ha ZK Konjuh, Drejtorati i Prokurimit pas kunsulltimit me gjithë pjesëmarrsit në procedurë ka ardhë në përfundim, që të stopohet procedura e filluar për shkëputje të kontratës në mënyrë që të jepet edhe një mundësi operatorit për realizmin e projektit të spitalit të përgjithshëm dhe special për alokolizëm dhe narkomani.

Me të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**Këshilla juridike:** Kundër këtij Aktvendimi nuk është lejuar ankesa, pasi që është bërë me marrëveshje në mes palëve, ky aktvendim është i plotfugishëm në ditën e shpalljes.

- Aktvendimi t'i dërgohet:
- Parashtruesit të kërkesës
  - DGJK-sektori për gjeodezi dhe kadastrë.

